

V E N D I M
Nr.337, datë 29.5.2003

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.222, DATË 15.5.1995 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SISTEMIMIN E INFORMACIONIT DHE TË DOKUMENTACIONIT
SHKENCOR DHE TEKNIK” DHE PËR MBYLLJEN E QENDRËS SË INFORMACIONIT
DHE TË DOKUMENTACIONIT SHKENCOR DHE TEKNIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik” dhe të neneve 121 e 124 të Kodit të Procedurave Administrative, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.222, datë 15.5.1995 të Këshillit të Ministrave.
2. Mbylljen e Qendrës së Informacionit dhe të Dokumentacionit Shkencor dhe Teknik.
3. Mjediset, fondi i dokumentacionit dhe buxheti i mbetur i vitit 2003 i Qendrës së Informacionit dhe Dokumentacionit Shkencor dhe Teknik të administrohen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.
4. Për punonjësit që janë në marrëdhënie pune me këtë qendër të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.
5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano